



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 611/ Prot.

Durrës, më 7.4.2023

VENDIM

Nr 18, datë 7.4.2023

PËR

"MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROGRAMIN E STUDIMIT "E DREJTË EVROPIANE DHE E KRAHASUAR/ COMPARATIVE AND EUROPEAN LAW", NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE, MASTER I SHKENCAVE, NË KUADËR TË DIPLOMËS SË DYFISHTË TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës ME UNIVERSITETIN E ROMËS, SAPIENZA, PRANË DEPARTAMENTIT TË DREJTËSISË NË FAKULTETIN E SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 41 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar me VKM Nr.879, datë 16.12.2019 "Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" në Udhëzimin Nr.1, datë 14.01.2020, "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për hapjen e programit të studimit në "E Drejtë Evropiane dhe e Krahasuar/ Comparative and European Law", ofruar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, me 120 kredite, në ciklin e dytë të studimeve, Master i Shkencave, në kuadër të diplomës së dyfishtë të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës me Universitetin e Romës, Sapienza, programi i studimit ofrohet pranë Departamentit të Drejtësisë në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike.
 2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - ✓ Drejtuesi i Njësive Kryesore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike
 - ✓ Drejtuesi i Njësive Bazë pranë Departamentit të Drejtësisë
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela **SOTIROFSKI**

